

VENDIM
Nr. 101, datë 9.5.2022

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALB - ENERGY” SHPK PËR RINOVIMIN E
LICENCËS NR. 367, SERIA T17, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 65,
DATË 11.5.2017**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 608/7 prot., datë 6.5.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ALB - Energy’ sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 367, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.5.2017”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ALB - Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 6281 prot., datë 4.5.2022, ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për rinovimin e licencës nr. 367, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.5.2017.

- Shoqëria “ALB - Energy” sh.p.k. ka depozituar një dokumentacion të konsiderueshëm bashkëlidhur aplikimit të saj për rinovim të licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, por ky aplikim nuk është paraqitur në afat, bazuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në mbështetje të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, shoqëria mund të paraqesë një aplikim të ri për licencim, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni i paraqitur për këtë aplikim do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur dhe pagesën e diferencës prej 10.000 lekësh, që përkon me licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1.- Të mosfillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 367, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “ALB - Energy” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.5.2017.

2.- Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti